



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.13, datë 28 .02. 2013

**PËR**

**“MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME (PJESA E PESTË) TË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË CILAT JANË NË TERRITORIN NËN JURIDIKSIONIN E BASHKISË SË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 8, pika 1/II, shkronja “a” dhe “c” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar); ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit të Ministrave nr.500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr.3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e pestë) të pronave të paluajtshme shtetërore të ndodhura në territorin nën juridiksionin e Bashkisë së Tiranës. Lista e inventarit (pjesa e pestë), fillon me numrin 6725 dhe mbaron me numër rendor 13724 dhe ka numër total faqesh 885 (tetëqind e tetëdhjetë e pesë).
2. Paraqitjen për miratim në Këshillin e Ministrave të Listës së Inventarit, sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**